

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.

**Pasqyrat financiare individuale
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

(dhe Raportin e Audituesve të Pavarur bashkëngjitur)

Përmbajtje

Rapori i audituesve të pavarur.....	i-iii
Pasqyra individuale e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital.....	3
Pasqyra individuale e flukseve monetare.	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare.....	5 – 36
Raporte plotësuese.....	I-II

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e Sigal Uniqa Group Austria sh.a,

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Sigal Uniqa Group Austria sh.a (“Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2021, pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat individuale financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare individuale, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.
- Marrim evidencë të mjaftueshme të auditimit të duhur në lidhje me informacionin financiar të njëjësive ekonomike ose aktiviteteve të biznesit brenda Shoqërisë për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare individuale. Ne jemi përgjegjës për kryerjen e auditimit të Grupit. Ne mbetemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brëndshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

29 prill 2022


Mediana Kodra, FCUB



SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.
Pasqyra individuale e pozicionit financiar
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë)

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Aktive			
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	9	77,652	84,633
Depozita me afat me bankat	10	4,511,556	4,456,883
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi	11	529,132	442,362
Tatim fitimi i arkëtueshëm	29	26,052	-
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	12	409,998	349,946
Llogari të arkëtueshme nga risigurimi	13	893,949	1,155,633
Investime në filiale	14	2,223,050	2,223,050
Aktive afatgjata materiale	15	1,036,010	1,013,593
Aktive të tjera	16	498,230	257,847
Totali i aktiveve		10,205,629	9,983,947
Detyrime			
Rezerva për dëme	17	2,878,822	2,914,708
Rezerva për primet e paguara	18	2,327,168	2,176,935
Tatim fitimi i pagueshëm	29	-	74,161
Detyrime të tjera	19	773,498	732,347
Totali i detyrimeve		5,979,488	5,898,151
Kapitali			
Kapitali aksionar	20	2,232,909	2,232,909
Rezerva të rrezikut të sigurimit	21	260,496	260,496
Fitimi i mbartur		1,732,736	1,592,391
Totali i kapitalit		4,226,141	4,085,796
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		10,205,629	9,983,947

Këto pasqyra financiare individuale janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Shoqërisë më 20 mars 2022 dhe janë firmosur nga:


 Ayni Ponari
 Drejtor përgjithshëm


 Klement Mersini
 Drejtor Finance



SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Prime të shkruara bruto	22	4,589,269	3,890,395
Ndryshimi në rezervat e primeve të pafituara	18	(150,233)	16,976
Primet bruto të fituara		4,439,036	3,907,371
Prime të ceduara në risigurim	23	(637,140)	(599,152)
Ndryshimi në risigurim në rezervat e primeve të pafituara	18	(86,797)	(31,778)
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		(723,937)	(630,930)
Të ardhura të tjera	24	95,355	71,198
Të ardhura neto		3,810,454	3,347,639
Ndryshimi në rezervat e dëmeve të sigurimit	17	35,886	830,770
Ndryshimi në pjesëmarrjen e risigurimit në rezervën e dëmeve	17	(174,888)	(886,133)
Dëme të paguara	17	(1,717,229)	(1,649,362)
Dëme të paguara të risiguruara	17	319,302	664,213
Dëme të sigurimit neto		(1,536,929)	(1,040,512)
Kostot e marrjes në sigurim	25	(778,363)	(646,619)
Shpenzime administrative	26	(977,375)	(936,783)
Shpenzime të tjera sigurimi	27	(132,688)	(184,442)
Fitimi operativ		385,099	539,283
Të ardhura nga investimet	28	112,487	3,334
Fitim/(Humbje) nga kursi i këmbimit		(60,293)	15,104
		52,194	18,438
Fitimi para tatimit		437,293	557,721
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	29	(63,348)	(104,339)
Fitimi i vitit		373,945	453,382
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit		373,945	453,382

Shënimet nga faqja 5 në 36 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë)

	Kapitali aksionar	Rezerva të rrezikut të sigurimit	Fitimi i mbartur	Totali
Gjendja më 1 janar 2020	2,232,909	260,496	1,139,008	3,632,413
Fitimi i vitit	-	-	453,382	453,382
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	453,382	453,382
Transaksione me pronarët e Shoqërisë				
Dividendë të paguar	-	-	-	-
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	2,232,909	260,496	1,592,390	4,085,795
Gjendja më 1 janar 2021	2,232,909	260,496	1,592,390	4,085,795
Fitimi i vitit	-	-	373,945	373,945
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	373,945	373,945
Transaksione me pronarët e Shoqërisë				
Dividendë të paguar	-	-	(233,599)	(233,599)
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	-	-	(233,599)	(233,599)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	2,232,909	260,496	1,732,736	4,226,141

Shënimet nga faqja 5 në 36 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.
Pasqyra individuale e flukseve monetare
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Flukset monetare nga veprimtaritë operative			
Fitimi para tatimit		437,293	557,721
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi	15	141,645	142,257
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale		778	-
Të ardhura nga interes	28	(22,656)	(18,095)
Të ardhura nga dividendët	28	(101,246)	-
Zhvlerësime të llogarive të arkëtueshme nga sigurimi	11	44,926	65,932
Flukset monetare nga veprimtaritë operative para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative			
Ndryshime në:		500,739	747,815
— llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi		261,684	917,911
— llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi		(131,696)	63,884
— kostot e shtyra të marrjes në sigurim		(60,052)	(13,094)
— aktivet e tjera		(240,383)	(97,660)
— rezervat për dëme		(35,886)	(830,770)
— rezervat për primet e pafituara		150,233	(16,976)
— detyrimet dhe provizionet e tjera		41,151	(51,207)
Mjetet monetare të gjeneruara nga veprimtaritë operative para interesit dhe tatimit		485,790	719,903
Tatimi fitimi i paguar		(163,561)	-
Interesa të arkëtuara		19,460	16,620
Flukset monetare neto nga veprimtaritë operative		341,689	736,523
Flukset monetare nga veprimtaritë investuese			
Flukse dalëse nga blerje e aktiveve afatgjata materiale	15	(164,840)	(146,914)
Flukse hyrëse nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	18,790
Investime në depozita me afat		(51,477)	(608,354)
Divident të arkëtuara	28	101,246	-
Flukset monetare neto të përdorura në veprimtaritë investuese		(115,071)	(736,478)
Flukset monetare nga veprimtaritë financuese			
Dividend të paguar		(233,599)	-
Flukset monetare neto të përdorura në veprimtaritë financuese		(233,599)	-
Pakësim neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre		(6,981)	45
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit		84,633	84,588
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit	9	77,652	84,633

Shënimet nga faqja 5 në 36 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria është themeluar në Shqipëri prej vitit 1999 si shoqëri sigurimi aksionare sipas ligjit shqiptar nr.8081, datë 7 mars 1996, "Mbi aktivitetin e sigurimit dhe risigurimit" dhe është regjistruar në Regjistrin Tregtar shqiptar nga Gjykata e Rrethit Tiranë sipas vendimit nr.20863, date 22 shkurt 1999. Shoqëria është subjekt i ligjit nr. 52/2014 "Mbi aktivitetin e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurim dhe risigurim" ("Ligji i sigurimit") i datës 4 korrik 2014.

Gjate vitit 2020, shoqëria meme e ndermjetme ka ndryshuar nga Uniqa Internationale Beteiligungs-Verwaltungs GmbH, Vienë, Austri ne shoqërine UNIQA Osterrich Versicherungen AG . Ky ndryshim per shoqërine meme te ndermjetme eshte bere ne Qenden Kombetare te Biznesit me daten 10.08.2020 me miratimin e Autoritetit te Mbikeqyrjes Financiare. Shoqëria mëmë përfundimtare është Uniqa Insurance Group AG, Vienë, Austri (shënimi 20).

Më 31 dhjetor 2021 Shoqëria mëmë e ndërmjetme është UNIQA Osterrich Versicherungen AG, Vienë, Austri.

Aktiviteti kryesor: Shoqëria ofron produktet e sigurimit jo-jetë si sigurimi i mjeteve motorike, pasurive të paluajtshme, shëndetin, transportin detar dhe ajror si dhe një seri produktesh të tjera sigurimi.

Adresa dhe vendndodhja e biznesit: Adresa e Shoqërisë është Blvd. "Zogu I", nr. 1, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria zotëron filiale ne Shqipëri, Kosovë, dhe Maqedoni të cilat operojnë në sigurimin jetës dhe jo-jetës.

Operacionet në Shqipëri

Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a. (99.9% në pronësi te Sigal Uniqa Group Austria sh.a.) - Në vitin 2004, Shoqëria hyri në biznesin e sigurimit të jetës në Shqipëri duke krijuar Sigal Life Sh.a., kapitali i të cilit aktualisht është 99.9% në pronësi të Shoqërisë.

Sh.a.f.p. Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a. (51% në pronësi te Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a.) u ble më 31 mars 2011 nga Sigal Life UNIQA Group Austria prej AVEL Sh.p.k. Më 20 prill 2011, në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, emri i entitetit të marrë në pronësi u ndryshua nga Capital I.P.P. sh.a në "Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria sh.a".

Operacionet në Kosovë

Sigal Uniqa Group Austria sh.a. – Prishtina (100% në pronësi te Sigal Uniqa Group Austria sh.a.) – u themelua gjatë 2003, si një degë e Shoqërisë territorin e Kosovës qe atëherë administrohej nga misioni i Kombeve te Bashkuara. Licenca u lëshua më 23 tetor 2003 nga Autoriteti i Bankave dhe Pagesave në Kosovë (tani Banka Qëndrore e Kosovës) dhe Shoqëria u regjistrua si një degë e Uniqa Group Austria sh.a. Në vitin 2012 dega ndryshoi statusin ligjor nga degë në filial.

Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a. – Prishtina (100% në pronësi te Sigal Uniqa Group Austria sh.a.) – u themelua më 10 maj 2011 për të ushtruar aktivitetin e sigurimit të jetës në Kosovë.

Operacionet në Maqedoni

Uniqa A.D. Shkup (99.94% ne pronësi te Sigal Uniqa Group Austria sh.a.) u themelua me 15 prill 2004 si Sigal AD - Shkup. Uniqa AD -Shkup është i licencuar të ofrojë 13 klasa të sigurimit të jo-jetës. Linjat kryesore të biznesit janë sigurimi i mjeteve motorike (TPL, motorike, policat e kufirit, kartoni gjelbër) pronën dhe aksidentet. Gjatë vitit 2007 emri zyrtar u ndryshua në "UNIQA AD Skopje".

Uniqa Life AD Shkup (100% në pronësi te Sigal Uniqa Group Austria sh.a.) - UNIQA Life AD Shkup u themelua më 29 qershor 2011, për të ushtruar aktivitetin e sigurimit të jetës në Maqedoni.

Përfaqësues i Shoqërisë është Z. Avni Ponari, në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm. Bordi i Mbikëqyrjes gjatë vitit 2021 dhe deri në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare individuale përbëhet si më poshtë:

Andreas Brandstetter	Kryetar
Dr. Erhard Busek	Anëtar
Alexander Breit	Anëtar
Wolfgang Kindl	Anëtar
Mag. Gerald Muller	Anëtar

2. Baza e Përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Detajet e politikave kontabël të Shoqërisë janë të përfshira në Shënimin 4.

(b) Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në bazë të kostos historike.

(c) Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare përgatiten në përputhje me parimin e vijueshmërisë, i cili nënkupton se Shoqëria do të vazhdojë operacionet e saj në një periudhë kohe të papërcaktuar, në të ardhmen e parashikueshme.

Mjaftueshmeria e Kapitalit

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021, shoqëria ka rezultuar me kapital prej 4,226,141 mijë lekë (2020: 4,085,796 mijë lekë), nivel të aftësisë paguese 1,324,512 mijë lekë (2020: 1,424,337 mijë lekë), dhe aktive në mbulim të provigjoneve teknike prej 121.96% (2020: 125.26 %) mbi nivelin e normave të kërkuara nga ligji dhe aktet rregulluese të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare. Për informacionin shpjegues rreth ligjit dhe rregulloreve në fuqi deri në datën e raportimit për llogaritjen e këtyre raporteve referojuni skeduleve suplementare.

(d) Filialet dhe konsolidimi

Filialet janë njësi të kontrolluara nga Shoqëria. Kontrolli ekziston kur Shoqëria ka fuqinë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, që të qeverisë politikat financiare dhe operative të një njësie ekonomike në mënyrë që të marrë përfitime nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit merren parasysh të drejtat potenciale të votimit që aktualisht janë të ushtrueshme ose të konvertueshme.

Shoqëria përgatit pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF për Grupin Sigal Uniqa Group Austria Sh.a., i cili përfshin Sigal Uniqa Group Austria Sh.a., Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a. dhe Sh.a.f.p. Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a. në Shqipëri, Sigal Uniqa Group Austria sh.a. dhe Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a. në Kosovë dhe Uniqa A.D. dhe Uniqa Life AD në Maqedoni. Në pasqyrat financiare të konsoliduara, Degët si edhe Shoqëritë e Kontrolluara, në të cilat Grupi kontrollon në mënyrë direkte ose jodirekte më shumë se gjysmën e të drejtave të votës, ose zoteron të drejtën për të ushtruar kontroll mbi aktivitetet e tyre, konsolidohen plotësisht.

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në faqen zyrtare të Shoqërisë Mëmë Sigal Uniqa Group Austria Sh.a. Përdoruesit e këtyre pasqyrave financiare për qëllime të veçanta duhet të lexojnë këto pasqyra si pjesë përbërëse të pasqyrave financiare të konsoliduara të Grupit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 për të marrë informacion mbi pozicionin financiar, performancën financiare dhe ndryshimeve në pozicionin financiar të Grupit në tërësi.

Mëma përfundimtare e Shoqërisë, Uniqa Insurance Group A.G, inkorporuar në Wien, Austri përgatit pasqyra financiare të konsoliduara që janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ('SNRF') dhe janë në dispozicion për përdorim publik.

Investimet në filiale në këto pasqyra financiare individuale kontabilizohen me kosto. Më shumë detaje të investimit në filiale janë të vendosura në Shënimin 14.

Investimet testohen për zhvlerësim sa herë që ka tregues se vlera kontabël e mbetur e tyre mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse vlera e rikuperueshme e një investimi (vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim) është më e vogël se vlera kontabël e saj, vlera kontabël neto reduktohet në shumën e rikuperueshme.

Vlera kontabël e mbetur e një investimi çregjistrohet gjatë nxjerrjes jashtë përdorimit. Diferenca midis vlerës së drejtë të fitimit nga shitjet dhe pjesës së mbetur të vlerës kontabël neto të investimit njihet në fitim ose humbje si fitim ose humbje nga shitja. E njëjta gjë vlen edhe nëse nxjerrja jashtë përdorimit rezulton në kalimin nga filiali në sipërmarrjen e përbashkët ose në pjesëmarrje të matur me kosto.

3. Monedha funksionale dhe e prezantimit

Pasqyrat financiare individuale janë paraqitur në Lek dhe rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Monedha funksionale e Shoqërisë është monedha në mjedisin primar ekonomik në të cilin ajo operon.

4. Politikat kryesore kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare individuale.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportit. Zërat jo-monetarë që maten me koston historike në monedhë të huaj përkthehen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit.

(b) Klasifikimi i kontratave të sigurimit

Kontratat nën të cilat Shoqëria pranon të marrë një rrezik të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakord të kompensojë policë-mbajtësin për një ngjarje të caktuar të pasigurt në të ardhmen (ngjarja siguroese) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin, klasifikohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të mundshme të ardhshme në një ose në disa norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, normat e kreditimit apo indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiarë kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

(c) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit

i) Kontratat e përgjithshme të sigurimit

Detyrimet e sigurimit janë llogaritur në mënyrë të veçantë për të gjitha produktet e sigurimit dhe janë të përbëra nga primet e angazhimeve të ardhshme (të pafituar), rreziku i angazhimeve të ardhshme (të pambaruara) dhe humbjet e angazhimeve të ardhshme (të papaguara në datën e mbylljes të vitit financiar). Detyrimet e sigurimit (provizionet) paraqesin vlerësime të pagesave të ardhshme për dëmet e raportuara dhe të pa-raportuara. Shoqëria nuk i skanton detyrimet e sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësim është reflektuar në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që lidhet me pasiguritë dhe kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të informuara. Shoqëria ka përdorur kërkesat e rregullatorit ose të mbikëqyrësit të sigurimeve të territorit ku veprojnë për të përcaktuar detyrimet e sigurimit.

ii) Prime të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Primet e shkruara bruto përbëjnë shumën e detyruar gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin direkt pavarësisht faktit se këto shuma i përkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhë kontabël të mëpasshme. Primet prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe përjashtojnë tatime dhe tarifën mbi primet. Primet janë fituar që nga data e lidhjes me rrezikun, për periudhën e dëmshpërblimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar. Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi për të cilat shuma e detyruar vlerësohet të jetë e pa arkëtueshme fshihen.

iii) Rezerva për primin e pafituar

Rezerva e primit të pafituar në të gjitha segmentet e biznesit përfshin atë pjesë të primeve të shkruara bruto e cila vlerësohet se do të fitohet në vitin pasardhës, duke përdorur metodën ditore në bazë proporcionale 1/365, e rregulluar në mënyrë që të reflektoj çdo ndryshim të ndodhjes së rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata.

Rezerva e primit të pafituar është ajo pjesë e primit e cila lidhet me periudha pas datës së raportimit. Primi i pafituar llogaritet nga primet e shkruara të cilat prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe përjashtojnë tatime dhe tarifa mbi primet. Kostot e shtyera të marrjes në sigurim njihen më vete si aktive.

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

(b) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit (vazhdim)

iv) Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim

Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim përfaqësojnë pjesën e shpenzimeve të marrjes në sigurim që kanë ndodhur dhe të ardhurave të marra, të cilat korrespondojnë me rezervën e primit të pafiturar. Ato janë përcaktuar si pjesë e shpenzimeve të marrjes në sigurim të përcaktuara si përqindje në planin teknik të sigurimeve dhe që lidhen me periudhat ndërmjet fundit të periudhës raportuese dhe datës së skadimit të kontratës së sigurimit. Shpenzimet aktuale të marrjes në sigurim dhe të ardhurat nga komisionet e risigurimit njihen respektivisht plotësisht si shpenzim dhe të ardhura në periudhën aktuale.

Shpenzimet e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që rrjedhin nga marrja në sigurim e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, siç janë komisionet e blerjes dhe koston e hartimit të dokumentit të sigurimit, shpenzimet administrative të ndara lidhur me përpunimin e propozimeve dhe lëshimin e politikave dhe tatimin në fuqi të primeve konsiderohet kosto shtesë që shkaktohet në marrjen e çdo sigurimi.

vi) Dëmet të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Dëmet e ndodhura përbëhen nga kostot e mbylljes dhe trajtimit të dëmeve të paguara dhe të papaguara që lindin nga ngjarje të ndodhura gjatë vitit financiar së bashku me rregullime të provizionit të dëmeve të vitit të mëparshëm. Dëmet e papaguara vlerësohen duke rishikuar dëmet individuale dhe llogaritjen e provizionit të dëmeve të ndodhura por ende të pa-raportuara, efekti i ngjarjeve të parashikuara brendshme dhe të jashtme, të tilla si ndryshimet në trajtimet e procedurave, inflacioni, tendencat juridike, ndryshimet legjislative dhe eksperiencat e mëparshme. Provizionin për dëmet e papaguara nuk skontohej. Rregullimet për provizionin e dëmeve të viteve të mëparshme reflektohen në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën bëhen rregullimet dhe paraqiten më vete nëse janë materiale. Provizionin për dëmet e ndodhura por të pa-raportuara vlerësohet në bazë të metodës së trekëndëshave të pagesave për produktin motorik-përgjegjësi ndaj palëve të treta ("MTPL") dhe për linjat e tjera të biznesit një metodologji e thjeshtëzuar në bazë të Normës së Primeve të Fituara.

Ndërkohë që Bordi i Drejtorëve konsideron se detyrimet e sigurimit për dëmet dhe marrjet nga risigurimi janë të drejta, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rrjedhojë e informacioneve dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në një rregullim të shumës së dhënë. Rregullimet për detyrimet e sigurimit reflektohen në pasqyrat financiare individuale në periudhën në të cilën bëhet rregullimi.

vii) Detyrimet e kushtëzuara për dëmet në proces gjyqësor

Një pjesë e konsiderueshme e dëmeve janë nën proces ligjor. Shoqëria ka regjistruar detyrime të përshtatshme të sigurimit bazuar në vlerësimin e drejtimit dhe në rastet e paraqitura në shënimin 30.

viii) Risigurimi

Shoqëria cedon primet e siguruar dhe rrezikun në rrjedhën normale të biznesit me potencialin e humbjes neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut që krijohet nga linjat e biznesit të motorëve dhe aksidenteve përfshirë këtu dhe kartonin e gjelbër, sigurimin e pasurisë, marinës dhe aviacionit, detyrime civile dhe detyrime të tjera dhe linja të tjera biznesi.

Risigurime të tilla përfshijnë marrëveshje të tejkalimeve të humbjeve dhe marrëveshjet fakultative. Vetëm kontratat që përfshijnë transferimin e një pjesë të konsiderueshme të rrezikut të sigurimit regjistrohen si llogari të arkëtueshme nga risigurimi. Marrëveshjet e risigurimit nuk e çlirojnë Shoqërinë nga detyrimet direkte ndaj policëmbajtësit. Detyrimet e risigurimit përfshijnë llogari të pagueshme për kontratat të jashtme risigurimi dhe njihen si shpenzime kur u mbaron afati.

Primet e risiguruara për risigurimin e ceduar njihen si shpenzim në mënyrë që të jenë konsistente me njohjen e primeve të lidhura me kontratat e sigurimit. Për sigurimin e përgjithshëm të biznesit, primet e risigurimit shpenzohen në periudhën në të cilën mbulimi i risigurimit jepet në bazë të modeleve të rrezikut të risiguar. Pjesa e pashpenzuar e primit të risigurimit të ceduar përfshihet në llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi. Shuma e njohur si llogari e arkëtueshme e risigurimit matet në mënyrë që të jetë konsistente me matjet e provizionit të mbajtur në përputhje me kontratat e sigurimit.

Llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi përfshijnë primet e ceduara tek risigruerit dhe arkëtimet nga shoqëria risigruuese në përputhje me dëmin e paguar. Këto janë klasifikuar si llogari të arkëtueshme dhe paraqiten të veçanta, nëse ka. Llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi vlerësohen për zhvlerësim në datën e raportimit. Një aktiv konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive, si rezultat i një ngjarje të ndodhur pas njohjes fillestare, që Shoqëria mund të mos marrë të gjitha shumat dhe ngjarja ka një impakt të matshëm në shumat që Shoqëria do të marrë.

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

(b) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit (vazhdim)

(ix) Kostot e trajtimit të dëmeve

Kostot e trajtimit të dëmeve përbëhen nga shpenzimet e jashtme të trajtimit të dëmeve dhe nuk përfshijnë shpenzimet e brendshme që konsiderohen të jenë jo të rëndësishme krahasuar me kostot e jashtme. Shoqëria krijon një zbritje për kostot e trajtimit të dëmeve brenda dispozitave përkatëse të trajtimit të dëmeve.

(x) Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Në çdo datë raportimi Shoqëria përgatit një test të përshtatshmërisë së detyrimeve. Testet e para që bëhen janë "Analiza e Raportit të Dëmeve" dhe "Analizën e Zhvillimit" të rezervave të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve realizohet çdo vit në mënyrë individuale për linjat kryesore të biznesit. Llogaritjet bëhen më vete për dëmet si dhe për dëmet që përfshijnë kostot e blerjeve si dhe kosto të tjera trajnimi. Në realizimin e kësaj analize Shoqëria merr në konsideratë vlerësime aktuale të flukseve monetare dalëse. Shoqëria nuk i skonton këto flukse pasi pjesa më e madhe e dëmeve pritet të zgjidhen brenda një viti. Si rezultat, Shoqëria realizon çdo vit Analizën e Zhvillimit të rezervave të dëmeve për të përcaktuar metodologjinë e rezervës. Kjo analizë realizohet në mënyrë të ndarë por dhe të kombinuar nga RBNS (të raportuara por ende të pazgjidhura) dhe IBNR (të ndodhura por të paraportuara). Në rastet kur analiza paraqet parregullsi të konsiderueshme, rregullime të caktuara u bëhen metodologjisë së rezervës. Nëse një mungesë identifikohet ajo i alokohet fitimit dhe humbjes duke vendosur një provizion për rrezikun e paskaduar nga humbjet që lindin nga testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve.

(c) Instrumentet financiare

Instrumentet financiarë të Shoqërisë maten me kosto të amortizuar në varësi të kategorisë së tyre të matjes.

Shoqëria klasifikon aktivet financiare jo-derivative në hua dhe të arkëtueshme dhe në aktivet e tjera aktivet e mbajtura deri në maturim dhe detyrimet financiare jo-derivative në detyrime të tjera.

i) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare jo-derivative - Njohja dhe çregjistrimi

Shoqëria fillimisht njeh llogaritë e arkëtueshme në datën datën e origjinës.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi ose transferon të drejtat për të marrë flukset monetare kontraktuale në një transaksion në të cilin transferohen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar, ose as nuk transferon dhe as ruan në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin mbi aktivin e transferuar. Çdo interes në aktivet financiare të tilla të çregjistruara që krijohen ose mbahen nga Shoqëria njihen si një aktiv ose detyrim i veçantë.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë.

ii) Aktivet financiare jo-derivative - Matja

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe aktivet financiare të mbajtura deri në maturim fillimisht maten me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni të drejtpërdrejtë që i atribuohet. Pas njohjes fillestare, ato maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

iii) Detyrimet financiare jo-derivative - Matja

Detyrimet e tjera financiare jo-derivative fillimisht maten me vlerën e drejtë minus kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen. Pas njohjes fillestare, këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

iv) Kompensimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare janë kompensuar dhe shuma neto është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të shlyer shumat dhe ka për qëllim të shlyejë në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidh detyrimin në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm kur lejohen nga standardet e kontabilitetit, ose për fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup i transaksioneve të ngjashme siç është aktiviteti i Shoqërisë.

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)**(c) Instrumentet financiarë (vazhdim)***v) Matja e vlerës së drejtë*

Vlera e drejtë është çmimi që do të merrej për të shitur një aktiv ose çmimi që duhet paguar për të transferuar një detyrim në një transaksion të zakonshëm ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes, ose në mungesë të kësaj, çmimi në tregun më të favorshëm në të cilin Shoqëria ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mos-performancës. Kur është e mundur, Shoqëria mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Tregu konsiderohet si aktiv nëse transaksionet për aktivin ose detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknikën e vlerësimit që maksimizojnë përdorimin e të dhënave përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave që nuk vëzhgohen. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në çmimet e një transaksioni.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit, përkatësisht vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë. Nëse Shoqëria konstaton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim identik ose të bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhguara, atëherë instrumenti financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të rregulluar për të shtyrë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimin e transaksionit. Më pas, ky ndryshim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme gjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet tërësisht nga të dhënat e tregut të vëzhgueshëm ose transaksioni mbyllet.

vi) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare që nuk mbarten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë të zhvlerësuar. Aktivet financiare janë të zhvlerësuar kur evidencat objektive tregojnë se një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe se ngjarja e humbjes ka një ndikim në flukset monetare të ardhshme të aktivit që mund të maten me besueshmëri.

Prova objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuar mund të përfshijnë vonesat ose falimentimin nga një huamarrës, ristrukturimin e një huaje ose parapagime me kushte që Shoqëria nuk do ta konsideronte ndryshe, tregues se huamarrësi do të hyjë në falimentim ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme në lidhje me një grup aktivesh të tilla si ndryshime të pafavorshme në statusin e pagesave të huamarrësve ose kushtet ekonomike që lidhen me dështimet në grup.

Shoqëria konsideron dëshmi të zhvlerësimit në të dy nivelet, kolektive dhe specifike. Aktivet financiare në nivel kolektiv vlerësohen për zhvlerësim duke grupuar së bashku klientët me karakteristika të ngjashme kreditore. Aktivet financiare në nivel specifik identifikohen në bazë të dëshmimeve objektive të një niveli rreziku që tejkalon nivelin historik të rrezikut të aktiveve të tilla si mungesa, ristrukturimi, kushtet e përkeqësuar ekonomike dhe delikuencës së më shumë se 90 ditëve për një klient të vetëm që nuk ka të ardhura të evidentuara. Kur një ngjarje e mëvonshme shkakton zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, humbja nga zhvlerësimi kthehet në fitim ose humbje.

(d) Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në arkë, depozitat e mbajtura me bankat dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturim fillestar prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes që i nënshtrohen një rreziku të parëndësishëm ndryshimi në vlerën e tyre të drejtë dhe janë përdorur nga Shoqëria në angazhimet e saj afatshkurtra.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(e) Depozitat me afat

Depozitat me afat janë paraqitur në pasqyrën individuale të pozicionit financiar në shumën e principalit të mbetur dhe klasifikohen si ato me maturim fillestar më shumë se tre muaj. Interesi është përlllogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe interesat e arkëtueshme pasqyrohen në të arkëtueshmet e tjera.

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)**(f) Të arkëtueshmet nga sigurimet dhe të arkëtueshmet e tjera**

Të arkëtueshmet, duke përfshirë llogaritë e arkëtueshme, fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar, minus humbjet nga zhvlerësimi.

(g) Të pagueshmet nga sigurimet dhe të pagueshmet e tjera

Të pagueshmet nga sigurimet dhe të pagueshmet e tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen. Pas njohjes fillestare, këto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(h) Aktive afatgjata materiale**(i) Njohja dhe matja**

Aktivet afatgjata materiale maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar (shih shënimin 15) dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kosto përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejt të atribueshme ndaj kostos së blerjes së aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte (nëse ka patur të përfshirë), çdo kosto tjetër drejtpërdrejt e atribueshme dhe që sjell aktivin në gjendjen e tij të parashikuar të punës, si dhe kostot e çmontimit dhe zhvendosjes së aktivitetit dhe rikthimit të vendndodhjes së tij në gjendjen e mëparshme dhe ndonjë kosto huamarrjes. Kur pjesët e një aktivi kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato konsiderohen si elementë të veçantë (komponentë kryesorë) të pajisjes.

Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit të një elementi të pajisjeve përcaktohen përmes krahasimit të të ardhurave të gjeneruara nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbetur të pajisjes, dhe njihen neto brenda të ardhurave të tjera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të elementit nëse pritet që prej këtij zëvendësimi të rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike për Shoqërinë dhe nëse kjo kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të riparimit të përhershëm të ndërtesës dhe pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhura shpenzimeve kur ato ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Toka nuk zhvlerësohet. Zhvlerësimi i përmirësimeve të objekteve me qira realizohet përmes metodës lineare mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të aktiveve, ndërsa vlerësimi i aktiveve të tjera afatgjata materiale llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur. Normat e përcaktuara të zhvlerësimit janë si më poshtë:

Kategoria	2021	2020
Ndërtesa	2.50%	2.50%
Mjete motorike	20%	20%
Pajisje kompjuterike dhe zyre	20%-25%	20%-25%

Vlera e mbetur, nëse është e rëndësishme, rivlerësohet në mënyrë të përvitshme. Përmirësimet e qiramarrjeve kapitalizohen dhe zhvlerësohen për më të voglën midis jetës së dobishme dhe kohëzgjatjes së qirasë.

Metodat e zhvlerësimit dhe të jetës së dobishme rivlerësohen dhe rregullohen nëse është e përshtatshme në çdo datë raportuese.

(i) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Në fund të çdo periudhe raportimi, drejtimi vlerëson nëse ka evidenca për zhvlerësim të aktiveve afatgjata materiale. Nëse ka tregues të tillë, drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila është përcaktuar si vlera më e lartë e vlerës së drejtë të një aktivi minus kostot për shitje dhe vlerës së tij në përdorim. Vlera kontabël neto është reduktuar në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave për vitin. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme është i kundërt në qoftë se ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivitetit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot për shitje.

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

(j) Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kostot rritëse direkt të ngarkuara në emetimin e aksioneve të reja paraqiten në kapital si deduksion, neto nga tatimi, nga të ardhurat. Çdo tejkalim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara është regjistruar si premium i aksioneve në kapital. Dividendët regjistrohen si detyrim dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Për çdo dividend të deklaruar pas datës së bilancit dhe para se pasqyrat financiare individuale të autorizohen për publikim janë dhënë informacion shpjegues në shënimin e ngjarjeve pas datës së bilancit.

(k) Njohja e të ardhurave

Politika e kontabilitetit në lidhje me të ardhurat nga kontratat e sigurimit paraqitet në shënimet 4.d.ii. Të ardhurat nga interesi mbi aktivet financiare njihen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat nga dividendi njihen në fitim ose humbje në datën e deklarimit të dividendit. Të ardhurat nga qiraja njihen si të ardhura në baza lineare gjatë afatit të qirasë.

(l) Përfitimet e punonjësve

i. Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore që ofrojnë përfitime pensioni për punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet përkatëse të sigurimeve shoqërore janë përgjegjëse për sigurimin e pragut minimal të përcaktuar ligjërisht për pension sipas një plani pensioni me kontribute të përcaktuara. Kontributet e Shoqërisë në planin e pensionit ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin dhe Shoqëria nuk detyrime të tjera.

ii. Leja vjetore e paguar

Shoqëria njih si një detyrim shumë të paskontuar të kostove të llogaritura lidhur me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

(m) Qiratë operative

Qiratë në të cilat një pjesë e konsiderueshme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra sipas qirasë operative janë ngarkuar me shpenzime në baza lineare gjatë periudhës së qirasë. Kur një qira operative përfundon para skadimit të afatit të qirasë, çdo pagesë që kërkohet t'i bëhet qiradhënësit me anë të dëmshpërblimi, njihet si një shpenzim në periudhën në të cilën kryhet ndërprerja.

(n) Provizionet

Një provizion njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual ose konstruktiv si rezultat i një ngjarjeje të shkuar dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke zbritur flukset e ardhshme të parasë në normën para tatimit. Provizionet pasqyrojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, kur është e përshtatshme, rreziqet specifike për detyrimin.

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

(o) Tatimet

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveçse kur lidhen me elementë që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Interesat dhe gjobat që lidhen me tatimin mbi fitimin, duke përfshirë trajtimet e pasigurta tatimore, trajtohen sipas *SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e Kushtëzuara*.

(i) Tatimi aktual mbi fitimin

Tatimi i periudhës aktuale është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose për t'u arkëtuar nga të ardhurat e tatueshme ose humbja për vitin dhe çdo rregullimi të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm përfaqëson vlerësimin më të mirë të bërë nga Shoqëria të tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet dhe që reflekton pasiguritë që lidhen me tatim fitimin, nëse ka. Tatimi aktual matet duke përdorur normat e taksave të miratuara ose të miratuara në mënyrë thelbësore në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale kompensohen vetëm nëse plotësohen kriteret e caktuara.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimi.

Aktivitet tatimore të shtyra njihen për humbjet tatimore të papërdorura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur që të kenë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Fitimet e ardhshme të tatueshme përcaktohen në bazë të ndryshimit të diferencave të përkohshme të tatueshme. Nëse shumat e diferencave të përkohshme të tatueshme është e pamjaftueshme për të njohur në tërësi një aktiv tatimor të shtyrë, atëherë konsiderohen fitimet e ardhshme të tatueshme, të rregulluara për anulimet e diferencave të përkohshme ekzistuese, bazuar në planet e biznesit.

Aktivitet tatimore të shtyra të panjohura rishikohen në çdo datë raportimi dhe njihen për aq sa është e mundur që përfitimi tatimor të realizohet. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme kur të kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do duhet të ndiqen nga mënyra se si Shoqëria pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose shlyejë vlerën e mbartur të aktiveve ose detyrimeve të veta. Aktivitet tatimor i shtyrë kompensohet me detyrimin tatimor të shtyrë vetëm në qoftë se kriteret e caktuara përmbushen.

(p) Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021

Ndryshimet e më poshtme efektive nga 1 Janar 2021 nuk kanë ndikim të rëndësishëm në rezultatin apo pozicionin financiar të Shoqërisë. Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto Pasqyra Financiare dhe për këtë arsye nuk janë paraqitur. Edhe pse, përderisa ato nuk ndikojnë në këto Pasqyra Financiare ato do të ndikojnë në disa njësi. Një njësi ekonomike duhet të vlerësojë ndikimin e këtyre standardeve të reja në Pasqyrat e tyre Financiare bazuar në faktet dhe rrethanat e tyre si dhe të bëjë të mundur dhënien e informacioneve të përshtatshme shpjeguese.

4. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

(q) Standardet dhe interpretimet e reja ende të pazbatuara

Standarde dhe amendamente të tjera që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar herët nga Shoqëria përfshijnë:

- NRF 17 Kontratat e Sigurimit
- Amendamentet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (Amendamentet në SNRF 17 dhe SNRF 4)
- Referencat në Kuader Konceptuale
- Të ardhurat para përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontrata të rënda - Kostoja e përbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF-së 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale (ndryshime në SNK 1)

Këto amendamente nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar dhe për këtë arsye informacioni shpjegues nuk është përfshirë.

SNRF 9 Instrumentet financiare

BSNK publikoi versionin përfundimtar të SNRF 9 (Instrumentet Financiare) në korrik 2014. Datat e ndryshme efektive të zbatueshme për SNRF 9 dhe SNRF 17 që duhet të zbatohen në periudhat raportuese që nga 1 janari 2021 do të rezultojnë në rritje të luhatjeve të fitimeve dhe dyfishimin e përpjekjeve të migrimit për periudhën e tranzicionit. Si rezultat i kësaj, BSNK publikoi rregullimet në vitin 2016 në SNRF 4 (Kontratat e Sigurimeve) të cilat lejojnë shoqëritë e sigurimeve të njohin fitime ose humbje të caktuara në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (përqasja mbuluese) ose të shtyjnë kohën fillestare të aplikimit për SNRF 9 deri sa SNRF 17 të hyjë në fuqi (qasja e shtyrjes) si pjesë e një procesi tranzicioni.

SNRF 17 Kontratat e sigurimit

SNRF 17 zëvendëson SNRF 4, i cili u paraqit si standard i përkohshëm në vitin 2004. SNRF 4 ka lejuar shoqëritë që të vazhdojnë të kontabilizojnë kontratat e sigurimit duke përdorur standardet kombëtare të kontabilitetit, duke rezultuar në një mori qasjesh të ndryshme.

SNRF 17 zgjidh problemet e krahasimit të krijuara nga SNRF 4 duke kërkuar që të gjitha kontratat e sigurimit të kontabilizohen në mënyrë konsistente, duke përfituar nga investitorët dhe shoqëritë e sigurimeve. Obligimet e sigurimit do të llogariten për përdorimin e vlerave aktuale, në vend të kostos historike.

Standarde të tjera

Në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare, disa Standarde të reja, por që nuk janë ende efektive, ndryshime në Standardet ekzistuese, dhe Interpretime janë botuar nga BSNK. Asnjë nga këto Standarde ose ndryshime në Standardet ekzistuese nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria.

Drejtimi parashikon që të gjitha Standardet përkatëse do të miratohen në periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të Standardit. Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e reja që nuk janë miratuar në vitin aktual nuk janë paraqitur në shënime shpjeguese pasi ato nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve

Shoqëria kryen vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit dhe të faktorëve të tjerë, duke përfshirë këtu pritjet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme për rrethanat ku ndodhin. Drejtimi gjithashtu kryen gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësimet, në procesin e zbatimit të politikave kontabël.

Pretendimet dhe përfitimet e policë-mbajtësit Vlerësimet e detyrimeve që lindin nga dëmet e ndodhura sipas kontratave të sigurimit është vlerësimi më kritik i kontabilitetit të Shoqërisë. Vendimet e Shoqërisë për humbjet e raportuara dhe të pa-raportuara dhe vendosja e rezervës për provizionet dhe risigurimi i rikuperueshëm rishikohen dhe përditësohen çdo vit, dhe rregullimet që rezultojnë nga ky rishikim reflektohen në fitim ose humbje. Procesi është i bazuar në supozimin se përvoja e kaluar, e përshtatur për efektin e zhvillimeve dhe trendëve aktuale është një bazë e duhur për të parashikuar ngjarjet e ardhshme. Administrimi i rrezikut të sigurimit është diskutuar me detaje në shënimin 6.

Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe humbjet nga zhvlerësimi Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe llogaritë e arkëtueshme të tjera njihen fillimisht me vlerë të drejtë. Më pas të njëjtat maten me kosto duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Vlerësimi i zbritjeve për humbjet nga zhvlerësimi është një vlerësim kritik i realizuar nga drejtimi. Vlerësimi për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme bëhet në çdo datë raportimi. Normalisht, llogaritë e arkëtueshme me më shumë se një vite vonesë zhvlerësohen plotësisht, më përjashtim të rasteve kur ka një probabilitet të lartë që do të arkëtohen. Ky probabilitet ekziston nëse Shoqëria ka marrëdhënie afatgjate me klientët ose kur Shoqëria blen të mira dhe shërbime nga i siguruari dhe të arkëtueshmet përcaktohen si shumë neto.

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit me vonesë më pak se një vit vlerësohen individualisht në rastet kur ato kanë vlerë të konsiderueshme dhe nëse ekzistojnë informacione që nuk do të mblihen. Llogaritë e arkëtueshme me vonesë më pak se një vit vlerësohen në grup duke u bazuar në vjetërsinë e tyre. Përqindja e provizionit që aplikohet për çdo kategori të llogarive të arkëtueshme me vonesë më pak se një vit përfaqëson vlerësimin më të mirë të drejtimit mbi humbjet e ardhshme dhe bazohen mbi eksperiencat e rimarrjes së viteve të mëparshme dhe të eksperiencave të tregut.

6. Administrimi i rrezikut të sigurimit

Shoqëria pranon rrezikun e sigurimit nëpërmjet kontratave të sigurimit ku merr përsipër rrezikun e humbjes nga personat ose organizatat që i nënshtrohen drejtpërdrejt humbjes themelore. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurisë që rrethon kohën, frekuencën dhe madhësinë e dëmeve sipas këtyre kontratave.

Rreziku i sigurimit lidhet me pasigurinë e biznesit të sigurimeve. Përbërësit më të rëndësishëm të rrezikut të sigurimit janë rreziku i primit dhe rreziku i rezervës. Këto kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e niveleve të normave të primit të sigurimeve dhe përshtatshmërinë e provizioneve në lidhje me detyrimet e sigurimeve dhe bazën e kapitalit. Rreziku i primit është i pranishëm kur policat lëshohet përpara se ndonjë ngjarje e siguruar të ketë ndodhur. Rreziku është që shpenzimet dhe humbjet e shkaktuara do të jenë më të larta se shuma e pranuar. Rreziku i rezervës përfaqëson rrezikun që niveli absolut i provizioneve teknike të vlerësohet ose që pretendimet aktuale do të luhaten rreth vlerës së mesatares statistikore.

Shoqëria administron rrezikun e saj nëpërmjet strategjisë së saj të nënshkrimit dhe risigurimit brenda një kuadri të përgjithshëm të administrimit të rrezikut. Çmimi bazohet në supozime që kanë të bëjnë me trendet dhe përvojën e kaluar. Ekspozimet administrohen duke pasur dokumentuar kufizimet dhe kriteret e nënshkrimit. Risigurimi është blerë për të zbutur efektin e humbjes potenciale ndaj Shoqërisë nga ngjarjet të mëdha ose katastrofike dhe gjithashtu për të pasur akses në specialistë të rreziqeve dhe për të ndihmuar në administrimin e kapitalit. Politikat e risigurimit janë të shkruara me risiguresit e aprovuar ose në bazë të kuotës ose tejkalimit të marrëveshjes së humbjes. Kapitali rregullator administrohet (megjithëse jo ekskluzivisht) duke iu referuar rrezikut të sigurimit në të cilin është ekspozuar Shoqëria.

Shoqëria shkruan rreziqe të pronës, detyrimeve dhe motorike kryesisht për një kohëzgjatje dymbëdhjetë mujore. Rreziqet më të rëndësishme lindin nga fatkeqësitë natyrore, ndryshimet klimatike dhe katastrofat e tjera (dëme të larta, ngjarjet me frekuencë të ulët). Një përqendrim rreziku mund të lindë gjithashtu nga një kontratë e vetme sigurimi e lëshuar për një tip të veçantë demografik të mbajtësit të policës, brenda një vendi geografik ose në llojet e biznesit komercial. Ndryshueshmëria relative e rezultatit zbutet nëse ka një portofol të madh me rreziqe të ngjashme.

6. Administrimi i rezikut të sigurimit (vazhdim)

Përqëndrimi i provizioneve të dëmeve sipas llojit të kontratës përmbledhet më poshtë duke iu referuar detyrimeve të sigurimit:

	2021			2020		
	Bruto	Risigurimi	Neto	Bruto	Risigurimi	Neto
Linja e biznesit						
Mjete motorike	2,194,115	(225,422)	1,968,693	2,005,803	(128,082)	1,877,721
Prona	628,430	(426,269)	202,161	858,862	(698,497)	160,365
Shëndeti dhe aksidentet	56,277	-	56,277	50,043	-	50,043
Totali	2,878,822	(651,691)	2,227,131	2,914,708	(826,579)	2,088,129

Përqëndrimi i provizioneve të primeve sipas llojit të kontratës përmbledhet më poshtë duke iu referuar detyrimeve të sigurimit:

	2021			2020		
	Bruto	Risigurimi	Neto	Bruto	Risigurimi	Neto
Linja e biznesit						
Mjete motorike	1,373,336	-	1,373,336	1,296,164	-	1,296,164
Prona	765,711	(240,904)	524,807	744,257	(321,380)	422,877
Shëndeti dhe aksidentet	188,120	(1,355)	186,765	136,513	(7,675)	128,838
Totali	2,327,167	(242,259)	2,084,908	2,176,934	(329,055)	1,847,879

Tabela e mëposhtme tregon dëmet aktuale të ndodhura në krahasim me vlerësimet e mëparshme për vitin 31 dhjetor 2021 dhe 2020:

	2021	2020	2019	2018	2017
RBNS					
Vlerësimet fillestare për dëmet					
Dëmet e periudhave të mëparshme të paguara gjatë vitit	1,956,213 (771,530)	2,635,617 (913,512)	1,562,151 (879,443)	1,480,768 (447,728)	1,225,311 (576,466)
Vlerësimet në fund për dëme të periudhave të mëparshme	(1,148,024)	(1,531,464)	(897,123)	(1,118,493)	(646,553)
Shmangja në mijë lekë	36,659	190,641	(214,415)	(85,453)	2,292
Shmangja në %	1.87%	7.23%	(13.73)%	(5.77)%	0.19%
IBNR					
Vlerësimet fillestare për dëmet	928,991	1,080,914	689,691	650,389	660,295
Dëmet e periudhave të mëparshme të raportuara gjatë vitit	(360,466)	(440,586)	(409,646)	(150,796)	(164,260)
Vlerësimet në fund për dëme të periudhave të mëparshme	(781,449)	(570,042)	(396,919)	(514,180)	(399,246)
Shmangja në mijë lekë	(212,924)	70,286	(116,874)	(14,587)	96,789
Shmangja në %	(22.92)%	6.50%	(16.95)%	(2.24)%	14.66%
Totali i rezervave për dëme					
Vlerësimet fillestare për dëmet	2,885,204	3,716,530	2,251,842	2,131,157	1,885,606
Të paguara dhe raportuara gjatë periudhës	(1,131,996)	(1,354,098)	(1,289,089)	(598,524)	(740,726)
Vlerësimet për dëme në fund	(1,929,473)	(2,101,506)	(1,294,042)	(1,632,673)	(1,045,799)
Shmangja në mijë lekë	(176,265)	260,926	(331,289)	(100,040)	99,081
Shmangja në %	(6.11)%	7.02%	(14.71)%	(4.69)%	5.25%

Dëmet aktuale në krahasim me vlerësimet

Provizionit për koston përfundimtare të pritshme të shlyerjes së të gjitha dëmeve të ndodhura në lidhje me ngjarjet deri në atë datë, qoftë të raportuara apo jo, së bashku me shpenzimet e trajtimit të dëmeve të lidhura, shumat e paguara më herët kryehen në datën e raportimit. Detyrimi për dëmet e raportuara (RBNS) vlerësohet në baza të veçanta rast pas rasti duke u bazuar te rrethanat e dëmeve, informatat në dispozicion nga rregulluesit e humbjes dhe evidencave historike të madhësive të ngjashme. Rezervat e dëmeve pezull rishikohen rregullisht dhe përditësohen në bazë të informacionit të ri. Drejtimi i Shoqërisë ka krijuar një proces të brendshëm në lidhje me njohjen dhe matjen e provigjoneve dhe detyrimeve të kushtëzuara për shkak të detyrimeve për dëmet e raportuara në proces gjyqësor.

6. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

Dëmet aktuale në krahasim me vlerësimet (vazhdim)

Supozimet kryesore në lidhje me mundësinë dhe madhësinë e një daljeje të burimeve bazohen në vlerësuesve dhe keshilltareve ligjore të brendshëm sipas strategjive përkatëse të mbrojtjes kundër veprimeve që mund të rezultojnë. Çdo veprim dhe risku përkatës vlerësohet në bazë të meritave të tij dhe detyrimit konstruktiv ose ligjor që lidhet kryesisht me komponentin jo material të dëmeve e TPL-se.

Vlerësimi i dëmeve të ndodhura por të pa-raportuara (IBNR) në përgjithësi është subjekt i një shkalle më të madhe pasigurie se sa dëmet e raportuara. Provizionet e IBNR vlerësohen kryesisht nga aktuarë të Shoqërisë duke përdorur teknika statistikore, ku të dhënat historike nxirren për të llogaritur kostot përfundimtare të pretendimeve.

Për aq kohë që këto metoda përdorin informacione historike të zhvillimit të pretendimeve për dëme mendohet se modeli historik i zhvillimi do të përsëritet në të ardhmen. Ka arsye pse ky nuk mund të jetë rasti, i cili, për aq sa ato mund të identifikohen, janë të lejuara për të modifikuar metodat. Arsye të tilla përfshijnë :

- tendencat ekonomike, ligjore, politike dhe sociale ekonomike (duke rezultuar në nivele të ndryshme të inflacionit nga ato të pritshme);
- ndryshimet në përzierjen e kontratave të sigurimit të krijuara;
- luhatjet e rastit, duke përfshirë ndikimin e humbjeve të mëdha.

Provizionet e IBNR vlerësohen fillimisht në një nivel bruto dhe një llogaritje e veçantë është kryer për të vlerësuar madhësinë e arkëtimeve nga risigurimi.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

6. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

Tabela e mëposhtme tregon zhvillimin gradual të vlerësimit të humbjes përfundimtare të bëra gjatë vitit. Vlerësimi pësoi ndryshime në periudha individuale në varësi të dëmeve aktuale të paguara. Krahasimi i vlerësimit statistikor të provizioneve të mjaftueshme me shumën bruto të provizioneve sugjeron nivele të mjaftueshme të provizioneve për dëme duke përfshirë dëmet e ndodhura por jo të raportuara.

Periudha e kontabilizimit	2014 dhe me heret	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Totali
Vlerësimi i kostos së dëmeve përfundimtare									
-në fund të periudhës raportuese	32,587,715	315,045	308,231	307,947	310,168	310,340	310,400	310,400	34,760
-një vit më vonë	8,828,016	402,454	402,970	402,226	399,829	399,741	396,030	-	-
-dy vite më vonë	9,881,581	480,912	480,642	479,606	478,316	476,655	-	-	-
-tre vite më vonë	11,166,566	525,257	521,476	520,488	520,453	-	-	-	-
-katër vite më vonë	12,105,420	714,254	713,993	709,593	-	-	-	-	-
-pesë vite më vonë	14,787,281	760,596	760,099	-	-	-	-	-	-
-gjashhtë vite më vonë	15,359,235	1,095,592	-	-	-	-	-	-	-
-shtatë vite më vonë	16,182,785	-	-	-	-	-	-	-	-
Vlerësimi aktual i kostove kumulative të dëmeve	16,182,785	1,095,592	760,099	709,593	520,453	476,655	396,030	310,400	20,451,607
Pagesat kumulative për dëme	7,084,644	1,547,217	1,464,800	1,711,284	1,353,005	2,505,558	901,382	1,035,675	17,603,565
Detyrimet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar	9,098,141	(451,625)	(704,701)	(1,001,691)	(832,552)	(2,028,903)	(505,352)	(725,275)	2,848,042

Drejtimi i shqyrton pretendimet e vlerësuara dhe supozimet e bazuara në zhvillimin aktual të dëmeve dhe kryen rregullimet e duhura në metodologjinë e dëmeve.

6. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

Supozimet e mëposhtme kanë efektin më të madh në matjen e detyrimeve të sigurimit jo-jetës:

Raporti i dëmeve të pritshme. Raporti i dëmeve të pritshme paraqet raportin e dëmeve të paguara dhe dëmeve që mund të ndodhin ndaj primeve të fituara duke përfshirë pjesën e risiguruesit dhe dëmeve të paguara dhe ndryshimet e pritshme (në RBNS dhe IBNR). Supozimet lidhur me raportin e dëmeve të pritshme për aksidentet të ndodhura gjatë viteve të fundit, për klasë të biznesit, kanë ndikimin më të madh në nivelin e provizioneve.

Faktorët pasues Për bizneset me cikël të gjatë kohorë, niveli i provizionit është ndikuar ndjeshëm nga vlerësimi i zhvillimit të dëmeve të ndodhura gjatë vitit të fundit, për të cilat të dhënat historike janë në dispozicion për zgjidhjen përfundimtare. Këta faktorë pasues vlerësohen me kujdes bazuar në përvojën e kaluar.

Skontimet. Dëmet për jo-jetën nuk skontojnë.

Procedimi i dëmeve

Dëmet e ndodhura procedohen përgjithësisht brenda një periudhe të shkurtër kohe dhe mbyllen zakonisht brenda një viti. Dëmet nga Kartonat e Gjelbër kanë një periudhë shlyerje më të gjatë e megjithatë jo më të gjatë sesa mbi një vit. Nga përvoja e Shoqërisë, procedimi i dëmeve nuk ndryshon në mënyrë materiale nga vlerësimet paraprake.

Supozimet dhe ndjeshmëritë

Rreziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jo-jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri variablash që e komplikojnë analizën kualitative të ndjeshmërisë. Shoqëria përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë tregues të tillë si raporti i humbjes së pritur. Shoqëria e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për dëmet e jo-jetës në sigurim që njihet në pasqyrat e pozicionit financiar për qëllime të veçanta. Megjithatë, përvoja aktuale do të ndryshojë nga rezultati i pritur. Një përmbledhje e humbjeve nga dëmet dhe raporti i kombinuar për vitin 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

	2021	2020
Raporti i dëmeve	35%	27%
Raporti i shpenzimeve	43%	45%
Raporti i kombinuar	78%	72%

Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë që tregojnë impaktin mbi fitimin përpara tatimit paraqiten më poshtë. Për këtë lloj ndjeshmërie tregohet ndikimi i një ndryshimi në një faktor të vetëm, duke mbajtur supozimet e tjera të pandryshuara.

	Impakti	2021	Impakti	2020
Raporti i dëmeve				
5% rritje në raportin e dëmeve	Humbje	(76,846)	Humbje	(52,026)
5% rënie në raportin e dëmeve	Fitim	76,846	Fitim	52,026
Raporti i shpenzimit				
5% rritje në raportin e shpenzimeve	Humbje	(94,421)	Humbje	(88,392)
5% rënie në raportin e shpenzimeve	Fitim	94,421	Fitim	88,392
Raporti i kombinuar				
5% rritje në raportin e kombinuar	Humbje	(171,267)	Humbje	(140,418)
5% rënie në raportin e kombinuar	Fitim	171,267	Fitim	140,418

7. Administrimi i rrezikut financiar

Funksioni i administrimit të rrezikut në Shoqëri është kryer në lidhje me rreziqet financiare, rreziqet operacionale dhe rreziqet ligjore. Rreziku financiar përfshin rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera të çmimeve), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit. Objektivat kryesore të funksionit të administrimit të rrezikut financiar janë për të vendosur kufijtë e rrezikut, dhe pastaj të sigurojnë që ekspozimi ndaj rreziqeve qëndron brenda këtyre kufijve. Funksionet operative dhe ligjore të administrimit të rrezikut kanë për qëllim sigurimin e funksionimit të politikave dhe procedurave të brendshme, në mënyrë që të minimizohen rreziqet operacionale dhe ligjore. Shoqëria nuk përdor instrumentet financiare derivative për t'u mbrojtur nga këto ekspozime ndaj rreziqeve.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.
Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

i) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përfshin tre lloje të rrezikut:

- Rrezikun e monedhës - rreziku që vlera e një instrumenti financiar të luhatet për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit;
- Rreziku i vlerës së drejtë të normës së interesit-rreziku që vlera e një instrumenti financiar të ndryshojë për shkak të luhatjes së normave të interesit të tregut;
- Rreziku i çmimit - rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhatet si rezultat i ndryshimeve në çmimet e tregut, pavarësisht nëse këto ndryshime shkaktohen nga faktorë specifikë të lidhur me instrumentin ose emetuesin e tij apo faktorë që prekin të gjithë instrumentet që janë të tregëtueshëm në treg.

Rreziku i tregut përfaqëson jo vetëm mundësinë për të humbur por edhe për të fituar. Drejtimi vendos limite mbi vlerën e rrezikut që mund të pranohet, që monitorohet mbi baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj përjasaje nuk i parandalon humbjet jashtë këtyre limiteve, në rast të lëvizjeve më të rëndësishme të tregut. Ndeshmëritë ndaj rreziqeve të tregut të dhëna në vijim bazohen në ndryshimin e një faktori duke mbajtur faktorët e tjerë konstantë. Në praktikë kjo ka shumë pak mundësi të ndodhë dhe ndryshimet në disa prej faktorëve mund të jenë të ndërlidhur për shembull ndryshimet në normat e interesit dhe ndryshimet në kurset e këmbimit.

ii) Rreziku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione si në monedhën lokale ashtu edhe në monedha të huaja; ndaj edhe lind rreziku nga luhatjet e kurseve të këmbimit. Për këtë arsye, luhatjet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja mund të ndikojnë në nivelin e kapitalit të aksionarëve pas përkthimit të saj në monedhën lokale. Rreziku i monedhës në portofolin e investimeve administrohet përmes përdorimit të parimit të përputhshmërisë së aktiveve me detyrimet. Normat zyrtare Bankare të aplikueshme (Lek për njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
USD	106.54	100.84
CHF	116.82	114.46
EUR	120.76	123.70

Shoqëria nënshkruan policat në Lek, Euro ose USD. Shoqëria hyn në marrëveshjet e risigurimit kryesisht në Euro, dhe blen mallra dhe shërbime në Euro dhe Lek ose USD. Për këtë arsye Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të valutës. Policat dhe proceset e Shoqërisë fokusohen në shmangjen e rrezikut të monedhës, përmes balancimit të shumës së mjeteve monetare të përdorura në secilën valutë, kryesisht duke investuar në depozitat me afat për të ekuilibruar detyrimet në valutat përkatëse.

Aktivitet dhe detyrimet e Shoqërisë në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2021 janë si më poshtë:

	Lek	EUR	USD (Ekuivalent në lekë)	CHF	Totali
Aktive					
Mjete monetare dhe ekuivalentë	29,977	35,919	11,706	50	77,652
Depozita me afat me bankat	713,671	3,431,068	366,817	-	4,511,556
Llogari të arkëtueshme nga sigurimet	217,763	270,255	41,114	-	529,132
Aktive të risiguresve	108,733	752,698	32,518	-	893,949
Aktive të tjera	11,027	149,321	-	-	160,348
Totali i aktiveve financiare	1,081,171	4,639,261	452,155	50	6,172,637
Detyrime					
Detyrimet e kontratave të sigurimit	(3,222,629)	(1,916,716)	(65,602)	(1,042)	(5,205,990)
Detyrime të tjera	(112,811)	(207,915)	(5,044)	-	(325,769)
Totali i detyrimeve financiare	(3,335,440)	(2,124,631)	(70,646)	(1,042)	(5,531,759)
pozicioni neto në monedhë të huaj	(2,254,269)	(2,514,630)	381,509	(992)	640,878

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.
Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)
7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)
ii) Rreziku i monedhës (vazhdim)

Aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	Lek	EUR	USD (Ekuivalent në Lek)	CHF	Totali
Aktive					
Mjete monetare dhe ekuivalentë	45,877	33,095	5,592	69	84,633
Depozita me afat me bankat	955,000	2,914,994	586,889	-	4,456,883
Të arkëtueshme nga sigurimet	204,249	141,258	96,855	-	442,362
Aktive të risiguruesve	282,413	820,274	52,946	-	1,155,633
Aktive të tjera	10,710	14,582	-	-	25,292
Totali i aktiveve financiare	1,498,249	3,924,203	742,282	69	6,164,803
Detyrime					
Detyrimet e kontratave të sigurimit	(3,095,801)	(1,887,856)	(106,711)	(1,275)	(5,091,643)
Detyrime të tjera	(153,219)	(75,382)	(56,621)	-	(285,222)
Totali i detyrimeve financiare	(3,249,020)	(1,963,238)	(163,332)	(1,275)	(5,376,865)
Pozicioni neto në monedhë të huaj	(1,750,771)	1,960,965	578,950	(1,206)	787,938

Analiza e Ndjeshmërisë

Tabela e mëposhtme detajon ndjeshmërinë e Shoqërisë për të rritur dhe ulur Lekun kundrejt monedhave të tjera relevante. Ky ndryshim në kurset e këmbimit përdoret kur bëhen raportimet e brendshme të rrezikut nga kurset e këmbimit për drejtimin e lartë dhe përfaqëson vlerësimin e drejtimit mbi ndryshimet e mundshme të kurseve të këmbimit valutor. Më poshtë paraqitet impakti i ndryshimit të një faktori të vetëm, ndërsa faktorët e tjerë mbahen të pandryshuar.

Analiza e ndjeshmërisë për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021:

	Ndikimi	Shuma
EUR rritet me 10% kundrejt Lekut	Fitimi	251,463
EUR bie me 10% kundrejt Lekut	Humbja	(251,463)
USD rritet me 10% kundrejt Lekut	Fitimi	38,151
USD bie me 10% kundrejt Lekut	Humbja	(38,151)

Analiza e ndjeshmërisë për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2020:

	Ndikimi	Shuma
EUR rritet me 10% kundrejt Lekut	Fitimi	196,096
EUR bie me 10% kundrejt Lekut	Humbja	(196,096)
USD rritet me 10% kundrejt Lekut	Fitimi	57,895
USD bie me 10% kundrejt Lekut	Humbja	(57,895)

iii) Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është i përbërë nga efektet e rrezikut të luhatjeve në nivelet ekzistuese të normave të interesit të tregut në pozicionin e saj financiar dhe të flukseve të mjeteve monetare. Gjatësia e kohës për të cilën norma e interesit është fikse në një instrument financiar kushtëzohet se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Aktivet dhe detyrimet financiare të shoqërisë mbartin normat e interesit të tregut.

	Deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 6 muaj	6 muaj deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Jo të ndjeshme ndaj interesit	Totali
Aktive						
Mjete monetare dhe ekuivalentë	-	-	-	-	77,652	77,652
Depozita me afat me bankat	1,891,031	1,107,811	1,512,714	-	-	4,511,556
Të arkëtueshme nga sigurimet	-	-	-	-	529,132	529,132
Aktive të risiguruesve	-	-	-	-	893,949	893,949
Aktive të tjera	-	-	-	-	160,348	160,348
Totali i aktiveve financiare	1,891,031	1,107,811	1,512,714	-	1,661,081	6,172,637
Detyrime						
Detyrimet e kontratave të sigurimit	-	-	-	-	(5,205,990)	(5,205,990)
Detyrime të tjera	-	-	-	-	(325,769)	(325,769)
Totali i detyrimeve financiare	-	-	-	-	(5,531,759)	(5,531,759)
Pozicioni neto më 31 dhjetor 2021	1,891,031	1,107,811	1,512,714	-	(3,870,678)	640,878

Shënime nga faqja 5 në 36 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

iii) Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

	Deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 6 muaj	6 muaj deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Jo të ndjeshme ndaj interesit	Totali
Aktive						
Mjete monetare dhe ekuivalentë	-	-	-	-	84,633	84,633
Depozita me afat me bankat	1,587,123	1,274,470	1,595,290	-	-	4,456,883
Të arkëtueshme nga sigurimet	-	-	-	-	442,362	442,362
Aktive të risiguruesve	-	-	-	-	1,155,633	1,155,633
Aktive të tjera	-	-	-	-	25,292	25,292
Totali i aktiveve financiare	1,587,123	1,274,470	1,595,290	-	1,707,919	6,164,802
Detyrime						
Detyrimet e kontratave të sigurimit	-	-	-	-	(5,091,643)	(5,091,643)
Detyrime të tjera	-	-	-	-	(285,222)	(285,222)
Totali i detyrimeve financiare	-	-	-	-	(5,376,865)	(5,376,865)
Pozicioni neto më 31 dhjetor 2020	1,587,123	1,274,470	1,595,290	-	(3,668,945)	787,938

Normat e interesit janë fikse. Megjithatë, ndonjë rritje/ ulje me 1% në normat e interesit do të kishte një efekt prej 45,116 mijë lekë (2020: 44,569 mijë lekë).

iv) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë i referohet rrezikut kur njëra palë në një instrument financiar do të shkaktojë humbje financiare palës tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi. Përgjatë kursit normal të biznesit, teksa arkëtohen primet, këto fonde investohen për të shlyer obligimet e ardhshme të policave. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë për aktivet financiare të mbajtura deri në maturim, depozitat me afat, të sigurimit dhe të arkëtueshme / aktivet.

Shoqëria ka vendosur procedura të brendshme dhe udhëzime sipas të cilave partnerët e risigurimit duhet të kenë vlerësime BB- ose më të larta dhe rreziku monitorohet nga personeli i risigurimit. Shoqëria administron ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë në mënyrë të rregullt përmes monitorimit të ekspozimit ndaj titujve të borxhit dhe kunderpartitë e depozitave me afat dhe nuk përqendron më shumë se 25% të fondit të garancisë tek një kundërparti. Përqendrimi i investimeve është i bazuar në performancën financiare të kundërpasive ashtu siç publikohen nga rregulluesit. Shoqëria investon vetëm në bankat që operojnë në Shqipëri dhe që rregullohen nga Banka e Shqipërisë.

Përsa i përket sigurimeve të arkëtueshme, Shoqëria monitoron ditët e kaluara. Në momentin që ditët e kaluara janë identifikuar, nën-funksionet e monitorimit të kredive të Shoqërisë kontaktojnë klientët dhe kuptojnë arsyet e vonesës. Në rast të mos efikasitetit të kontakteve fillestare, Shoqëria identifikon të gjitha marrëdhëniet me klientin, në mënyrë që të marrë masat e duhura për të shmangur rrezikun e kredisë duke përfshirë mbledhjet dhe telefonatat e shumta me palën tjetër, identifikimin e detyrimeve të palës tjetër në mënyrë që një marrëveshje për kompensim mund të arrihet.

Ekspozimi maksimal i shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë sipas klasës së aktiveve është reflektuar në vlerat kontabël të aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë:

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Mjete monetare dhe ekuivalentë (përfshirë arkën)	9	74,910	81,780
Depozita me afat me bankat	10	4,511,556	4,456,883
Të arkëtueshme nga sigurimet	11	529,132	442,362
Llogari të arkëtueshme nga risigurimi	13	893,949	1,155,633
Aktive të tjera	16	160,348	25,292
Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë		6,169,895	6,161,950

Asnjë shenjë objektive për zhvlerësim nuk është identifikuar nga Shoqëria për aktivet e tjera financiare në datën e raportimit, prandaj drejtuesit marrin në konsideratë aktivet e tjera financiare si ekuivalentët e mjeteve monetare, depozitat me afat dhe aktivet e tjera si as të kaluara dhe as të zhvlerësuara. Referohu shënimeve për cilësinë e kredisë së aktiveve financiare.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare individuale

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

iv) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre dhe depozitat me afat të Shoqërisë janë vendosur në këto institucione financiare:

	Agjencia	Vlerësimi	31 dhjetor 2021		31 dhjetor 2020	
			Mjete monetare dhe depozita me afat	Nga të cilat mjete monetare dhe depozita me afat (Shënimi 9)	Mjete monetare dhe depozita me afat	Nga të cilat mjete monetare dhe depozita me afat (Shënimi 9)
Banka Kombëtare Tregëtare	JCR	AAA (Alb)	1,801,373	14,559	1,494,396	12,781
Intesa San Paolo Bank	Eurasia		60,455	13,030	240,301	4,805
Raiffeisen Bank	S&P	BBB	41,656	5,433	45,118	10,832
Credins Bank	Pa vlerësim	-	584,294	6,481	680,423	1,959
Banka Amerikane e Investimeve	Pa vlerësim	-	845,996	3,396	834,202	16,950
OTP Bank	S&P	BBB	567,179	8,954	565,062	9,084
ProCredit Bank	Fitch	BBB	186,595	4,469	181,578	3,455
Tirana Bank	S&P	CCC+	404,068	2,541	408,158	4,896
United Bank of Albania	S&P	AAA+	3,437	3,437	3,692	3,692
Alpha Bank – Albania	S&P	CCC+	13,727	3,727	17,434	7,434
Union Bank	Pa vlerësim	-	65,431	6,298	60,164	4,231
First Investment Bank	Fitch	B-	2,585	2,585	1,661	1,661
Totali i mjeteve monetare dhe depozitave me bankat (Shënimi 9 dhe shënimi 10)			4,576,796	74,910	4,532,189	81,780

Shoqëria operon me bankat lokale. Llogaritë me bankat nuk janë të kolateralizuara. Për shkak se disa banka shqiptare vlerësohen nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit, Shoqëria përdor vlerësimet e kreditit të aksionarëve më të mëdhenj të bankave për të marrë vendimet e saj të investimeve si dhe raportet tremujore të Bankës së Shqipërisë mbi bankat që operojnë në tregun shqiptar.

Llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi monitorohen sipas vlerësimit të kredisë. Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, vlerësimi i rrezikut të kredisë për primet e ceduara tek risiguresit dhe llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi sipas vlerësimit të risiguresit (kërkesë nga legjislacioni lokal) janë si më poshtë:

Vlerësimi	2021				2020			
	Prime të ceduara		Llogari të arkëtueshme nga risigurimi		Prime të ceduara		Llogari të arkëtueshme nga risigurimi	
	'000 lekë	% e totalit	'000 lekë	% e totalit	'000 lekë	% e totalit	'000 lekë	% e totalit
A	468,857	74%	778,635	87%	460,031	77%	1,028,513	89%
BBB	136,799	21%	115,314	13%	113,839	19%	127,120	11%
BB	31,484	5%	0	-	25,282	4%	0	-
Totali	637,140	100%	893,949	100%	599,152	100%	1,155,633	100%

